



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

NJOFTIM PËR MEDIA

Ditën e premte, në datën 30 shtator 2022, në mjediset e Autoritetit të Mediave Audiovizive, AMA u zhvillua mbledhja e radhës së AMA-s, ku morën pjesë anëtarët e mëposhtëm:

Armela	KRASNIQI	Kryetar
Desada	METAJ	Zëvendëskryetar
Aurela	BICJA	Anëtar
Besian	ZOGAJ	Anëtar
Gjergji	HAMITI	Anëtar
Jetmir	HALILAJ	Anëtar
Joana	ALLUSHI	Anëtar

AMA, pas shqyrtimit të çështjeve të rendit të ditës vendosi:

1. Heqjen e licencës të shoqërisë “Intel Media” sh.p.k., për subjektin audioviziv privat “Tv Jug”. **(Vendimi nr. 101, datë 30.09.2022)**
2. Heqjen e licencës të shoqërisë “ABEG” sh.p.k., për subjektin audioviziv privat “ABEG Tv”. **(Vendimi nr. 102, datë 30.09.2022)**
3. Heqjen e licencës të shoqërisë “ABEG” sh.p.k., për subjektin audio privat “Radio ST”. **(Vendimi nr. 103, datë 30.09.2022)**
4. Heqjen e autorizimit të subjektit person fizik Ramazan Ringaj, për ofrimin e shërbimit të programit audioviziv mbështetur në rrjet kabllor “Tv Puka”. **(Vendimi nr. 104, datë 30.09.2022)**
5. Refuzimin e ankimit administrativ dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 6 datë 17.06.2022 për dënimin me gjobë, në masën 1 000 000 (një milion) lekë, të subjektit person fizik Guri Meko, autorizuar për përsëritjen e programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Tv me kabëll Aral”. **(Vendimi nr. 105, datë 30.09.2022)**
6. Refuzimin e ankimit administrativ dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 7 datë 24.08.2022 për dënimin me gjobë, në masën 2 000 000 (dy milion) lekë, të shoqërisë “Tibo” sh.p.k., për subjektin OSHMA “Tibo”. **(Vendimi nr. 106, datë 30.09.2022)**

AMA, pasi u njoh me relacionet dhe projektvendimet të shoqërisë “Top Gold” sh.p.k., licencuar për subjektin audio privat “Top Gold” dhe të shoqërisë “MY TV ALB” sh.p.k., autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve, online mbështetur në rrjet IP (OTT) “My Tv-Alb”, u shpreh me votë për lënien në fuqi të licencës/autorizimit të këtyre subjekteve.

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Tiranë, më 30 shtator 2022